



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesuese e KD-së
Mr. Ardiana Bunjaku

Nr. Prot.: 4/297
Datë: 16/11/2018


Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina, në mbledhjen e mbajtur më 15. 11. 2018, mori:

V E N D I M

- I. Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për vitin akademik 2018/2019 do të ndajë bursa për të gjithë studentët e nivelit bachelor, të cilët i plotësojnë kriteret e propozuara sipas konkursit publik me nr. prot: 4/295 16.11.2018.
- II. Lartësia e bursës universitare për vitin akademik 2018/19, për çdo përfitues do të jetë 600 euro, e cila ndahet për rezultatet e arritura gjatë viti akademik 2017/18. Bursa ndahet për periudhën e studimeve, përkatësisht për 10 muaj të vitit akademik.
- III. Për studentët që janë përfitues të bursës universitare, ndarja e mjeteve do të bëhet në vitin akademik 2018/19 nga buxheti i vitit 2019.
- IV. Shërbimi financiar i njësive akademike në bashkëpunim me Shërbimi Financiar të Universitetit të Prishtinës, obligohen që të zbatojë këtë vendim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Vendim t'i dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Njësive akademike të UP-së,
3. Shërbimit financiar të UP-së,
4. Zyrës Ligjore të UP-së .

Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. Ardiana Bunjaku - Kryesuese
